UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

# UDHËZUES I PRAKTIKËS PROFESIONALE NË SHKOLLË

## Për programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"

Elisabeta Osmanaj
Beatriçe Gani
Dhurata Turku
Alma Muharremi

SHPRESA print
Shtypshkronjë & Shtëpi botuese

# UDHËZUES
# I PRAKTIKËS PROFESIONALE NË SHKOLLË

## Për programin e studimit Bachelor në
## "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"

SHPRESA print
Shtypshkronjë & Shtëpi botuese

Korrik, 2023

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”**
**FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT**

**Autorë:**
Elisabeta Osmanaj
Beatriçe Gani
Dhurata Turku
Alma Muharremi

**Bashkëpunëtorë:**

Ornela Bilali
Xhevdet Zekaj

**Redaktor shkencor:**
Ardjan Turku

Udhëzuesi u hartua nga FSHE dhe u financua nga AKKSHI, në kuadër të Programit Kombëtar të Kërkim-Zhvillimit 2022-2023

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Ndalohet kopjimi, fotokopjimi, shumëfishimi i materialit, apo pjesëve të veçanta të tij në çfarëdo lloj forme, pa lejen e autorëve.

**Tel:** ++3555425259

**E-mail:** uniel.edu.al, info@uniel.edu.al

## Tabela e përmbajtjes

I Shkurtime ....................................................................................5
I.I Parathënie ....................................................................................6
I.I.I Hyrje ....................................................................................7
I.I.I.I Pohime ....................................................................................8

**PJESA 1**

SISTEMI I MENTORIMIT ....................................................................................13
1.1Sistemi i mentorimit, institucionet dhe aktorët ........................................13
1.2Mentori, roli dhe përgjegjësitë ....................................................................14
1.3Koordinatori i universitetit, roli dhe përgjegjësitë ....................................15
1.4Tutori (mbikqyrësi universitar), roli dhe përgjegjësitë ..............................15
1.5Pedagogët e lëndëve të programit universitar të studimit ........................16
1.6Studenti praktikant, të drejtat dhe përgjegjësitë ........................................17

**PJESA 2**

KUPTIMI MBI FAZAT DHE AKTIVITETET, KORNIZËN E KOMPE-
TENCAVE DHE VLERËSIMIN E STUDENTIT ........................................21
2.1Fazat ....................................................................................21
2.2Aktivitetet ....................................................................................22
2.3Korniza e aftësive dhe e kompetencave ....................................................23
2.4Vlerësimi ....................................................................................25
2.5Kujtesë për koordinatorin, tutorin, mentorin dhe studentin ......................27

**PJESA 3**

FAZA E PARË E PRAKTIKËS PROFESIONALE ......................................31
3.1Informacion mbi vendin e PP në programin e studimit për fazën 1 ........31
3.2Aktivitetet e fazës së pare ....................................................................33
3.3Korniza e aftësive dhe kompetencave – faza e parë ..................................41
3.4Formati i vlerësimit – faza e pare ...........................................................52

**PJESA 4**

FAZA E DYTË E PRAKTIKËS PROFESIONALE ......................................55
4.1Informacion mbi vendin e PP në programin e studimit për fazën 2 ........55
4.2Aktivitetet e fazës së dytë ....................................................................56
4.3Korniza e aftësive dhe e kompetencave – faza e dytë ..............................63
4.4Formati i vlerësimit – faza e dytë ...........................................................72

**PJESA 5**

FAZA E TRETË E PRAKTIKËS PROFESIONALE....................................74
5.1Informacion mbi vendin e PP në programin e studimit për fazën 3 ........74
5.2Aktivitetet e fazës së tretë ....................................................................75
5.3Korniza e aftësive dhe kompetencave – faza e tretë ................................80
5.4Formati i vlerësimit – faza e tretë ..........................................................88

LITERATURA...........................................................................................89

## Shkurtime

| | |
|---|---|
| A | Aktivitet |
| A-K-V | Aktivitete – Kompetenca - Vlerësim |
| APU | Arsimi Parauniversitar |
| ASCAP | Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar |
| B | Bllok |
| DPAP | Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar |
| DRAP | Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar |
| F | Fazë |
| F1S1 | Faza e parë, Semestri i parë etj. |
| F1-G3-A11 | Faza e parë, Grupi i tretë, Aktiviteti i njëmbëdhjetë etj. |
| Fa | Fakulteti |
| FSHE | Fakulteti i Shkencave të Edukimit |
| G | Grupi |
| IAL | Institucioni i Arsimit të Lartë / Universiteti |
| IAP | Institucionet e Arsimit Parauniversitar |
| IAPP | Institucioni Arsimor i Praktikave Profesionale |
| IZHA | Instituti për Zhvillimin e Arsimit |
| K.3.2 | Kompetenca 3 treguesi 2 etj. |
| Ko | Koordinatori universitar |
| M | Mentori |
| MAS | Ministria e Arsimit dhe Sporteve |
| MU | Mbikëqyrësi universitar |
| PPBS4 | Praktika Profesionale Bllok e Semestrit të Katërt |
| Pe | Pedagogu |
| PL | Pedagogu i Lëndës |
| PP | Praktika Profesionale |
| S1/S2 | Semestri i parë / Semestri i dytë etj. |
| S | Seriale |
| St | Studenti |
| TIK | Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit |
| ZVAP | Zyra Vendore Arsimit Parauniversitar |

# I. PARATHËNIE

Udhëzuesi është hartuar nga FSHE si pjesë e projektit "Vlerësimi i praktikave profesionale përmes kornizës së kompetencave për studentët kandidatë për mësues" të financuar nga AKKSHI në kuadër të Programit Kombëtar të Kërkim - Zhvillimit 2022 – 2023, mbështetur në përvojën dhe traditën tonë por edhe në punën hulumtuese të grupit të punës dhe të bashkëpunëtorëve, me qëllim përmirësimin e praktikave profesionale dhe përditësimin me kërkesat e kohës për mësuesin e shekullit të 21- të. Risitë e udhëzuesit kanë të bëjnë me:

- standardizimin e përfshirjes së studentit në PP për programet e studimit në FSHE;
- ndarjen e PP në faza dhe vendosjen e "gurëve kilometrikë" përgjatë rrugëtimit të formësimit profesional;
- dizenjimin e veprimtarive (aktiviteteve) ku do të përfshihet studenti në çdo fazë;
- formulimin e sjelljeve profesionale të shpresuara në fund të çdo faze (korniza e aftësive, shprehive, bindjeve a qëndrimeve, kompetencave),
- mënyrën e vlerësimit mbi bazën e kornizës së kompetencave.

Këto risi janë rezultat i punës hulumtuese dhe në linjë me rekomandimet e MASH se "Është e domosdoshme *një kornizë koherente e kompetencave të mësuesve fillestarë* e cila mundëson orientimin dhe përafrimin e kurrikulave të përgatitjes së mësuesve dhe mbështet fort zhvillimin e mësuesve përgjatë karrierës. Përmes kornizave të tilla të kompetencave, politikat mund të krijojnë një kuptim, zotërim dhe gjuhë të përbashkët mes grupeve të interesit dhe fazave të ndryshme përgjatë karrierës së mësuesit"[1]

Jemi të bindur se ky udhëzues i praktikave profesionale për Programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" do t'i shërbejë përmirësimit të përgatitjes më të mirë profesionale të studentëve- mësues.

*Autorët*

---

1 MASH, IZHA: "Raport, Formimi Fillestar i Mësuesve në Institucionet e Arsimit të Lartë Shqiptar" Tiranë 2016, f.45.

## I.I HYRJE

Universiteti i Elbasanit ka traditë në përgatitjen e mësuesve. FSHE në vazhdimësi ka riparë programet e studimit me qëllim përmirësimin dhe bashkëkohëzimin e përgatitjes së mësuesve për të qenë në nivelin e traditës dhe konkurrues në tregun e punës. Një nga përbërësit e rëndësishëm të planit mësimor në kuadër të programit të studimit është praktika profesionale. Ajo është konceptuar e lidhur ngushtë me programet lëndore të studimit dhe me synimin që modeli ynë i përgatitjes së mësuesve të rinj të ezaurojë sa më shumë që të jetë e mundur problematikën mbarëbotërore të shkëputjes së teorisë nga praktika.

Programi i studimit "Mësues për ciklin Parashkollor" me kohëzgjatje 3-vjeçare u hap për herë të parë në vitin akademik 1995-1996 pranë UE "Aleksandër Xhuvani". Diploma që lëshohej nga Fakulteti i Mësuesisë për kl.1-4 dhe Parashkollor titullohej "Mësues për ciklin Parashkollor". Në vitin 2010 e në vazhdim ky program studimi emërtohet "Bachelor" në Mësuesi për Arsimin Parashkollor.

Programi i studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" është program i ciklit të parë të studimit, organizuar me 180 kredite evropiane dhe kohëzgjatje normale 3 vite akademike. Ky programi synon të përgatisë mësues për arsimin parashkollor me një formim të lartë teoriko-praktik, të aftë për t'iu përgjigjur me sukses proceseve reformuese në sistemin arsimor parashkollor dhe kërkesave në rritje të tregut të punës për punonjës arsimorë me kualitet të lartë, me njohuritë bazë të domosdoshme dhe integruese për këtë cikël studimi mbi metodat dhe parimet shkencore drejt një mësimdhënieje sa më të suksesshme, si edhe kërkimit didaktik dhe pedagogjik në edukim. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit, si dhe aftësimit profesional duke synuar në përgatitjen e mësuesve për arsimin parashkollor të aftë për të zhvilluar veprimtarinë mësimore në institucionet e arsimit parashkollor; përgatitjen e profesionistëve të zotë në mësimdhënie me interes për dijen dhe kërkimin shkencor; orientimin e studentëve drejt një mësimdhënieje sa më të suksesshme, si dhe kërkimit didaktik dhe pedagogjik në të gjitha displinat shkollore; demonstrimin e gatishmërisë dhe të shkathtësive për zhvillimin e projekteve në institucionet arsimore dhe zhvillimin e shkathtësive për hulumtime në mjedise shkollore dhe më gjerë.

Studentët e programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" angazhohen në praktikë, për t'u aftësuar si mësues të arsimit parashkollor. Praktika parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik profesional. Qëllimi

parësor i praktikës profesionale është që studentëve në këtë program studimi t'u ofrohet mundësia për të zhvilluar shkathtësitë për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në arsimin parashkollor, që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënies brenda kulturës së kopshtit dhe të grupit/klasës.

### I.I.I.I POHIME PËR TË KUPTUARIT E UDHËZUESIT

Për të lehtësuar të kuptuarit e këtij udhëzuesi, më poshtë jepen disa pohime që kanë të bëjnë me frymën dhe vlerat që FSHE mbart dhe promovon, mbështetjen në kuadrin ligjor, strukturën dhe aspektin përmbajtësor të tij.

**Pohimi 1:**

Udhëzuesi mbështetet në disa vlera bazë që Fakulteti i Shkencave të Edukimit, mbështetur në traditën e Normales së Elbasanit dhe më tej, synon t'i mishërojë te studentët e tij:

- Të konsideruarit e profesionit të mësuesit si privilegj që shoqëria ta beson.
- Të konsideruarit e mësuesit si mishërim i modelit më pozitiv profesional e qytetar.
- Të konsideruarit e mësuesit si promovues i barazisë, i guximit dhe i drejtësisë shoqërore.
- Të konsideruarit e mësuesit si model i etikës së sjelljes në çdo mjedis e rrethanë.
- Të konsideruarit e mësuesit si qenie humane që ndërton marrëdhënie të forta me nxënësit, prindërit dhe komunitetin mbështetur në besimin, respektin reciprok dhe pranimin e përgjegjësive.

**Pohimi 2:**

Udhëzuesi ecën në të njëjtën linjë me kuadrin ligjor kombëtar përfshirë aktet normative, Statutin e Universitetit "Aleksandër Xhuvani" dhe Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Edukimit.

**Pohimi 3:**

Udhëzuesi ka si udhërrëfyes Standardet Profesionale të Formimit të Përgjithshëm të Mësuesit të Arsimit Parashkollor [2], Standardet Profesionale të Formimit të Përgjithshëm dhe të Formimit Lëndor të Mësuesit në Sistemin Arsimor Parauniversitar[3], dokumentin e MARS mbi kompetencat e mësuesve

---

2 MARS & ASCAP: "Standardet Profesionale të Formimit të Përgjithshëm të Mësuesit të Arsimit Parashkollor", 2018.

3 MASR & ASCAP: "Standardet Profesionale të Formimit të Përgjithshëm dhe të Formimit

të rinj në përfundim të stazhit[4], shtojcës nr. 3 të saj. Përtej këtyre ai mbështetet ngushtësisht deri në detaje me programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" në FSHE, me programet lëndore të tij në çdo aspekt sidomos në atë të formimit profesional.

**Pohimi 4:**

Udhëzuesi i praktikave profesionale operon mbi bazën e tri fazave të dakordësuara të zhvillimit të kompetencave profesionale të studentëve që diplomohen si mësues të arsimit parashkollor.

**Pohimi 5:**

Në përputhje me tri fazat, janë përcaktuar grupet e aktiviteteve që synojnë formimin e aftësive dhe të kompetencave përkatëse në nivelin e përcaktuar të formulimeve përkatëse të "sjelljes profesionale" të shpresuar, për çdo fazë. Përfshirja në "aktivitete" dizenjohet sipas një përshkallëzimi drejt vendosjes së studentit nga vëzhgues dhe ndihmës drejt rolit të mësuesit të klasës.

**Pohimi 6:**

Formulimet e sjelljeve profesionale, të grupuara për çdo fazë, konturojnë nivele të caktuara të elementëve përbërës të kompetencave (njohuri, aftësi, bindje, qëndrime) sipas një përshkallëzimi që mundëson rritjen hap pas hapi të profilit profesional të studentit- mësues. Në harmoni me synimet e programit të studimit dhe të programeve lëndore udhëzuesi formulon sjelljet e shpresuara profesionale apo pritshmëritë për studentët.

**Pohimi 7:**

Studentët zhvillojnë njohuritë, aftësitë, bindjet, qëndrimet dhe demonstrojnë vlerat përmes tri fazave sipas një procesi jo linear. Kjo buron nga fakti se studentët me kapacitete dhe individualitete të ndryshme, ndodhen në kontekste të shumëllojshme shkollore ku formëzimi individual profesional varet shumë nga kombinimet e këtyre faktorëve.

**Pohimi 8:**

Për secilën fazë, formulimet e sjelljes profesionale si shprehje të arritjeve nga aktivitetet ku përfshihet studenti, grupohen dhe sintetizohen në kompetenca. Këto formulime të sintetizuara në nivelin e arritjes profesionale maksimale të

Lëndor të Mësuesit në Sistemin Arsimor Parauniversitar ", Korrik 2020.

4 MAS: Urdhër Nr. 100, datë 25.02.2022: "Për Miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Zhvillimin e Praktikave Profesionale për Profesionin e Rregulluar të Mësuesit".

shpresuar nga studenti për fazën përkatëse (niveli i kompetencës) përfaqësojnë njëkohësisht edhe standardin e kompetencave të parashikuara nga programi i studimit deri në atë moment. Në respekt të zhvillimit profesional jolinear të studentëve si edhe të lehtësimit të vlerësimit të tyre mbi bazën e kompetencave, udhëzuesi përmban edhe formulimet e ndërmjetme që i korrespondojnë vlerësimeve "dobët", "mjaftueshëm", "mirë" dhe "shumë mirë".

**Pohimi 9:**

Kuadri i kompetencave që përshkallëzohet në këtë udhëzues, udhëheq formimin profesional të studentëve ndërkohë që ata janë të përfshirë në programin e mësimdhënies dhe të të nxënit, mbështetur fort në kornizën kurrikulare të arsimit parashkollor.

# Pjesa I

# SISTEMI I MENTORIMIT

## 1.1 Sistemi i mentorimit, institucionet dhe aktorët

Universiteti i Elbasanit, në vazhdën e traditës së Shkollës Normale, ka ruajtur dhe forcuar marrdhëniet me IAP-të shprehur qartë sidomos në zhvillimin e PP. Aktualisht, FSHE dhe institucionet parashkollore, mbështetur në dëshirën e mirë reciproke për partneritet, me dakordësinë e autoriteteve qendrore, zyrave vendore arsimore dhe bashkive, bashkëpunojnë që studentët e programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" të zhvillojnë PP. Rregullorja e miratuar nga MAS e përcjellë përmes Urdhërit Nr. 100, datë 25.02.2022 "Për Miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Zhvillimin e Praktikave Profesionale për Profesionin e Rregulluar të Mësuesit", shërben si bazë për rregullimin e këtij bashkëpunimi.
Modeli i bashkëpunimit mbështetet në atë që në dekada është quajtur "Sistemi i mentorimit". Institucionet partnere të përfshira në këtë bashkëpunim janë:

- DPAP - Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
- ZVAP - Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, sipas juridiksionit
- DRAP - Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, sipas juridiksionit
- IAPP - Institucionet Arsimore të Praktikës Profesionale (shkollat/kopshtet partnere)
- IAL – Institucionet e Arsimit të Lartë (Universiteti i Elbasanit)
- FSHE – Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti i Elbasanit
- Bashkitë

Aktorët kryesorë që realizojnë bashkëpunimin, organizimin dhe realizimin me sukses të praktikës, janë:

- M – Mentori
- T – Tutori (mbikqyrësi universitar)
- S – Studenti
- KU – Koordinatori (koordinatori universitar i bashkëpunimit)
- PL – Pedagogu i lëndës

## 1.2 Mentori, roli dhe përgjegjësitë

Roli dhe përgjegjësitë e mentorit përcaktohen në rregulloren zyrtare për praktikat profesionale[5].

**Roli i mentorit:**

1. Mentori ndihmon praktikantin të kryejë me sukses praktikën profesionale nëpërmjet:
   a. zhvillimit të aftësive dhe shprehive të praktikantit përmes vëzhgimeve, këshillimeve, rekomandimeve, komenteve dhe veprimtarive të ndryshme;
   b. krijimit të mundësive për praktikantin, në zbatim të metodave bashkëkohore dhe ndërvepruese në mësimdhënie;
   c. përdorimit të mjeteve të ndryshme zhvillimore për praktikantin si: detyra, pjesëmarrje në grupe pune, trajnime afatshkurtra, këshillime karriere personale etj.;
   d. mbikëqyrjes së vazhdueshme të performancës së praktikantit sipas instrumenteve të përcaktuara në këtë Rregullore;
   e. sigurimit për praktikantin të informacionit të nevojshëm për sistemin arsimor shqiptar, duke i rekomanduar atij literaturë bashkëkohore;
   dh. motivimit të praktikantit për të synuar nivele të larta të performancës.

**Përgjegjësitë e mentorit:**

a. për ecurinë e praktikës profesionale të praktikantit dhe për vlerësimin e tij në fund të saj;
b. të njohë praktikantin me këtë Rregullore dhe me formatin e vlerësimit të praktikantit nga mentori;
c. të hartojë, në bashkëpunim me praktikantin, planin mujor të orëve të vëzhgimit nga praktikanti dhe orët e planifikuara si mësues ndihmës (grupet dhe datat);
ç. të zhvillojë seanca bashkëbisedimi dhe këshillimi me praktikantin;
d. të hartojë planin ditor të mentorit ku përshkruan veprimtarinë e tij si mentor në orët e vëzhgimit dhe të shënojë konstatimet dhe këshillat kryesore për seancat këshilluese me praktikantin;
e. të plotësojë vlerësimin e praktikantit për çdo orë vëzhgimi të planifikuar (sipas shtojcës nr. 2, ("Formati i vëzhgimit", bashkëlidhur

5 MAS: "Rregullore për Organizimin dhe Zhvillimin e Praktikave Profesionale për Profesionin e Rregulluar të Mësuesit", nenet 10, 11., Tiranë, 25.02.2022.

kësaj rregulloreje);

f. të ndihmojë praktikantin për përgatitjen e portofolit që duhet të dorëzojë në përfundim të praktikës;
g. të përgatisë raportin e vlerësimit, në përfundim të veprimtarisë së praktikantit (sipas shtojcës nr. 3, "Vlerësimi i praktikantit", bashkëlidhur kësaj rregulloreje).

Studentët praktikantë janë nën detyrimin e programit përkatës të studimit në universitet. Në këto kushte, disa nga pikat e mësipërme mbi rolin dhe përgjegjësitë e mentorit, pa e përjashtuar këtë të fundit, bashkëndahen me mbikqyrësin universitar.

### 1.3 Koordinatori i universitetit, roli dhe përgjegjësitë

- organizon praktikën profesioanale, duke bashkëpunuar me rrjetin e institucioneve pritëse dhe hartuar grafikun e shpërndarjes së studentëve praktikantë;
- bashkëpunon ngushtësisht me mësuesit mentorë, drejtoritë përkatëse, DRAP, studentët praktikantë etj. për një koordinim sa më të mire;
- siguron informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për studentët praktikantë, mësuesit mentorë dhe drejtoritë e institucioneve pritëse;
- identifikon nevojat për zhvillim profesional të mësuesve mentorë në lidhje me praktikat;
- bashkëpunon, merr pjesë në hartimin dhe organizimin e trajnimeve për mësuesit mentorë;
- identifikon nevojat për ndryshim të praktikës profesionale dhe inicion këto ndryshime;
- organizon vlerësimin përfundimtar në bashkëpunim me mësuesin mentor, drejtorinë e shkollës/kopshtit dhe tutorin;
- mban kontakte të vazhdueshme me departamentet e universitetit;
- raporton në fakultet për ecurinë e praktikës profesionale;
- mban dhe krijon arshivën me dosjet e praktikave profesionale sipas rregullave për dokumentacionin.

### 1.4 Tutori (mbikqyrësi universitar), roli dhe përgjegjësitë

- studion dokumentacionin e praktikës profesionale dhe njeh në detaje atë;
- organizon dhe promovon praktikën profesionale të studentëve

praktikantë;
- vëzhgon dhe udhëzon për mbarëvajtje sa më të mirë të praktikës profesionale;
- merr pjesë në diskutime për përmirësimin e praktikës profesionale;
- njeh problematikat e mësimdhënies dhe të të nxënit, si dhe zhvillimet aktuale në arsim;
- mbështet veçanërisht lidhjen midis programit të studimit në auditore dhe zbatimit të njohurive të marra në praktikën profesionale me qëllim formësimin e aftësive dhe kompetencave;
- siguron shoqërim individual të studentit praktikant, duke mbajtur shënime në dosjen e praktikës, si dhe në formë elektronike;
- gjatë ndihmës për studentin praktikant bashkëpunon me mësuesin mentor;
- organizon diskutime me studentët praktikantë pas orëve të mësimit;
- plotëson dokumentacionin përkatës për studentin praktikant;
- merr pjesë në vlerësim së bashku me mësuesin mentor, grumbullon dokumentacionin e praktikës profesionale dhe ia kalon koordinatorit;
- evidenton nevojat, merr pjesë në planifikimin dhe në kualifikimet për mësuesit mentorë.

Pra, tutori ka një rol të rëndësishëm në praktikën profesionale si:
- person burimor;
- këshillues;
- përkrahësi gjithanshëm moral;
- lehtësues;
- harmonizues i programit dhe aktiviteteve në fakultet me praktikën profesionale;
- interpretues i reagimeve dhe reflektimeve;
- vlerësues.

## 1.5 Pedagogët e lëndëve të programit universitar të studimit

Pedagogët e lëndëve të ndryshme parashikuar në planin mësimor nuk janë pjesë e drejtëpërdrejtë e sistemit të praktikës profesionale por indirekt ato luajnë një rol shumë të rëndësishëm. Përvoja e FSHE-së konsiston në forcimin e lidhjes së njohurive që trajtohen në auditore me PP, sidomos në dhënien e detyrave me natyrë kërkimore dhe zbatimin në praktikë të gjetjeve. Për këtë, në udhëzues përfshihen shkurtazi elementë që i kujtojnë të gjithë aktorëve (studentëve, mentorëve, tutorëve, pedagogëve etj.) detyrimet për një lidhje

sa më të ngushtë të njohurive teorike dhe lëndëve mësimore që zhvillohen paralelisht apo alternohen me praktikën profesionale.

Pedagogët e lëndëve kanë përgjegjësi:

- të njohin strukturën e praktikës profesionale dhe fazat e saj;
- të njohin kërkesat e secilës fazë për formësimin e kompetencave të studentëve;
- të bëjnë lidhjen midis përmbajtjes lëndore të lëndës që zhvillojnë dhe kërkesave të PP që zhvillohet paralelisht apo që studenti has;
- të orientojnë detyrat e kursit drejt kërkimit apo hulumtimit për situata të mësimdhënies dhe të të nxënit që hasen në klasë/grup dhe reflektimit me qëllim sjelljen e ndryshimit;
- të vendosin komunikim të përhershëm me tutorin dhe mentorin me qëllim përmirësimin e PP;
- të bashkëpunojnë për forcimin e marrëdhënieve IAL – kopsht në aspektin e shkëmbimit të përvojave për të rejat në fushën e edukimit dhe nevojat për trajnime.

## 1.6 Studenti praktikant, të drejtat dhe përgjegjësitë

Studenti është në qendër të të gjithë procesit të PP.

Studenti praktikant:

- Ka detyrimin që të njohë në detaje kërkesat e PP në aspektin organizativ dhe përmbajtësor përmes këtij udhëzuesi dhe bashkëpunimit të ngushtë me aktorët e tjerë që janë M, T, Ko, PL;
- Diskuton situatën e tij profesionale me mësuesin mentor dhe mbikqyrësin universitar;
- Është i gatshëm për të shkëmbyer përvoja me persona të tjerë të përfshirë në këtë program;
- Vlerëson këshillën e mësuesit mentor dhe e përdor atë për përmirësimin e praktikës profesionale.

Karakteristikat

- Të jetë i interesuar për nxënie dhe zhvillim profesional;
- Të jetë në gjendje të marrë përgjegjësi profesionale dhe të përfitojë nga mbështetja dhe njohuritë e ofruara nga mentori;
- të jetë në gjendje të shprehë nevojat dhe pyetjet e tij lidhur me profesionin e mësimdhënies;

- të jetë i hapur me komentet dhe udhëzimet e mentorit apo ekipit mentor;
- Të perceptojë mentorimin si një marrëdhënie e rëndësishme ndihmëse për progres në profesionin e mësimdhënies.

Rregulla

- Studenti praktikant duhet të marrë pjesë në seanca të detyrueshme të programit para se të kryejë këtë praktikë;

- Studenti praktikant respekton orarin dhe rregullat e shkollës/kopshtit si dhe përmbush të njëjtat detyrime si edhe mësuesi mentor;

- Studenti praktikant është i pranishëm përgjatë gjithë praktikës profesionale;

- Studenti praktikant realizon numrin e ditëve të parashikuara në kalendar, në rast mungese ai lajmëron mësuesin mentor dhe pedagogun përgjegjës. Ai mund të plotësojë ditët e humbura në fund të praktikës ose gjatë saj sipas grafikut të përcaktuar nga tutori në dakordësi me mentorin;

- Studenti praktikant harton dhe paraqet brenda afateve të caktuara mendimet dhe diskutimet e tij, broshurën e praktikës dhe raportin sintezë, si dhe dorëzon një përmbledhje me shkrim;

- Studenti praktikant, nëse është e mundur, kryen praktikën profesionale në mënyrë të vazhdueshme te të njejtët fëmijë, sipas fazës së zhvillimit të praktikës profesionale.

# Pjesa II

# KUPTIMI MBI FAZAT DHE AKTIVITETET, KORNIZËN E KOMPETENCAVE DHE VLERËSIMIN E STUDENTIT

## 2.1 Fazat

PP në FSHE është konceptuar në tri faza. Secilës fazë i korrespondon një set i caktuar aftësish, bindjesh, qëndrimesh, vlerash dhe kompetencash profesionale që studenti duhet të përvetësojë. Duke kaluar përmes këtyre fazave të PP në FSHE ai/ajo krijon dhe formëson profilin e tij professional. Me fazë, kuptueshëm, kemi parasysh pjesën e udhëtimit të studentit përgjatë praktikës profesionale, në fund të së cilës shpresohet, që mbi bazën e objektivave të paracaktuara, të arrihet një nivel i caktuar, i dallueshëm, i formimit profesional[6]. Studenti, deri në diplomim, do të kalojë përmes tri të tillave. Fazat nuk përfaqësojnë thjesht ndarje kohore. Ato dallojnë nga njëra-tjetra nga shkalla e përfshirjes së studentit në jetën profesionale të shkollës/kopshtit, deri në rolin e plotë si mësues i klasës/grupit, dhe përfundimi i secilës prej tyre mbart pritshmëritë e formësimit të një kapaciteti të caktuar aftësish, shkathtësish, bindjesh dhe kompetencash.

Periudha e formimit fillestar të mësuesve të rinj, në dokumentet e Komisionit Evropian, përcaktohet me fokusin "duke u bërë mësues"[7]. Në FSHE, duke qëndruar në të njejtën linjë terminologjike, për të karakterizuar fokusin e aktiviteteve përdorim qasjen:

- Faza 1: Njohje - vëzhgim
- Faza 2: Alternim rolesh me mësuesin
- Faza 3: Në rolin e mësuesit

Në vijim, janë dizajnuar setet e aktiviteteve apo detyrave ku do të përfshihet studenti me qëllim pasurimin e njohurive profesionale dhe zhvillimin e aftësive gjithnjë e më komplekse drejt automatizimit të sjelljeve profesionale, në përshkallëzim dhe përputhje me emërtimin e fazave. Aftësitë, shprehitë, bindjet, kompetencat, në përfundim të fazave të praktikës, duhet të shfaqen në nivelin e shpresuar për të cilin harta e aktiviteteve është skicuar, nivel i cili duhet të dokumentohet me formulime vlerësuese të sjelljes profesionale. Është

6 Turku A.: "Formësimi i kompetencave të mësuesve të rinj përmes praktikave profesionale", ShB "Rama Graf", Elbasan 2021, f. 102.

7 Komisioni Evropian: "Shaping career-long perspectives on teaching. A guide on policies to improve Initial Teacher Education", 2015, f. 17.

e kuptueshme që anasjelltas, këto formulime të sjelljeve profesionale njëherazi duhet të shprehin bagazhin e kompetencave për studentët, në momentin që përfundojnë fazën e praktikës, programin e studimit apo diplomohen. Me këtë nivel profesional studentët kalojnë në fazën pasuese të praktikës në IAL.

## 2.2 Aktivitetet

PP, me qëndrimin në shkollë/kopsht dhe përgatitjen jashtë kohës së qëndrimit në shkollë/kopsht, është detyrë që kërkon angazhim shumë të madh nga ana e studentëve, pavarësisht nëse është dita e parë apo e fundit e saj. Programi i PP është dizajnuar për të filluar nga gjërat më të thjeshta drejt atyre më komplekse, nga formimi dhe konsolidimi i aftësive drejt integrimit dhe shndërrimit të tyre në kompetenca, nga fitimi dhe konsolidimi i njohurive drejt formimit të bindjeve dhe zhdërvjelltësimit për t'i aplikuar në praktikë. Udhëzuesi e realizon këtë përmes "aktiviteteve" në të cilat përfshihet studenti, sipas një rendi që mundëson kalimin nga faza e *njohje- vëzhgimit* në *ndihmës dhe alternim rolesh me mësuesin* për kalimin në fund të PP në *rolin e mësuesit*.

Aktivitetet janë ato të cilat përcaktojnë në linja të përgjithshme se çfarë do të bëjë studenti në çdo ditë të praktikës profesionale, që nga dita e parë e fazës së parë deri ditën e fundit të fazës së fundit. Performanca e studentëve gjatë PP nuk është e njëjtë. Pavarësisht se të gjithë studentët do të kalojnë në të njejtën linjë të aktiviteteve, dikush avancon më shpejt e dikush më ngadalë. Meqenëse procesi mësimor ka të bëjë me procesin e të nxënit të fëmijëve, nuk mund të lejohet një student të kalojë në rolin e mësuesit për zhvillimin e një etape apo të një ore të plotë mësimi nëse ai nuk ka performuar mirë në planifikimin e një ore mësimi apo në rolin si ndihmës i mësuesit. Është mentori ai që përcakton se kur një student do të kalojë nga një aktivitet në një më të avancuar në rrugën e formimit profesional.

Aktivitetet e dizajnuara nga FSHE për PP të studentëve strukturohen në **shtatë grupe** si më poshtë[8]:

### G1. Parapërgatitja dhe njohja

**A.1 -** Njohja me sistemin e PP;
**A.2** – Vizita e parë në shkollë/kopsht;
**A.3 -** Njohuri ligjore mbi institucionin arsimor;
**A.4 -** Njohja me dokumentacionin e shkollës/kopshtit dhe atë të detyrueshëm të studentit praktikant;
**A.5** –Njohja me literaturën, veçanërisht me botime të MAS dhe IZHA.

8 Turku A.: "Formësimi i kompetencave të mësuesve të rinj përmes praktikave profesionale", ShB "Rama Graf", Elbasan 2021, f. 129-131.

**G2. Vëzhgimi dhe mbajtja e shënimeve**

**A.6 -** Prani/vëzhgime/shënime gjatë përgatitjes së një ore/dite mësimi;
**A.7** - Prani/vëzhgime/shënime gjatë zhvillimit të mësimit;
**A.8 -** Prani/vëzhgime/shënime gjatë përgatitjes së një aktiviteti me fëmijët jashtë orës së mësimit;
**A.9 -** Prani/vëzhgime/shënime gjatë aktiviteteve me komunitetin e të nxënit.

**G3. Përfshirje e studentit si ndihmës i mësuesit**

**A.10 –** Ndihmës i mësuesit në parapërgatitjen e një ore mësimi;
**A.11** – Ndihmës i mësuesit gjatë zhvillimit të një ore mësimi;
**A.12 -** Ndihmës i mësuesit në përgatitjen dhe zhvillimin e aktiviteteve mësimore jashtë orës së mësimit;
**A.13 –**Ndihmës i mësuesit në përgatitjen dhe zhvillimin e aktiviteteve me prindërit dhe komunitetin.

**G4. Përfshirje e studentit në rolin e mësuesit**

**A.14 –** Në rolin e mësuesit në planifikimin, parapërgatitjen, organizimin dhe zhvillimin e një episodi apo etape të orës së mësimit;
**A.15** – Në rolin e mësuesit për planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e një ore mësimore, në një ditë praktike;
**A.16 -** Në rolin e mësuesit për planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e dy orëve mësimore, në një ditë praktike;
**A.17 –**Në rolin e mësuesit për planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e një dite të plotë pune;
**A.18** - Në rolin e mësuesit në një aktivitetet me prindërit dhe komunitetin.

**G5. Përfshirje e studentit në jetën profesionale të stafit pedagogjik**

**A.19 -** Përfshirje e studentit si dëgjues në mbledhje të ekipeve të kopshteve dhe aktivitete të tjera kualifikuese që organizohen në shkollë/kopsht.
**A.20** - Pjesëmarrje në mbledhjet e mësuesve**.**

**G6. Lidhja me programet lëndore dhe aktivitetet në fakultet**

**A.21**– Lidhja midis njohurive dhe detyrave që shtjellohen dhe zhvillohen në kuadër të programeve lëndore në fakultet dhe terrenit

konkret të kopshtit.
**A.22**–Pjesëmarrja në punë hulumtuese dhe aktivitete promovuese të saj dhe në kuadër të punimit të temave të diplomës**.**

### G7. Aktivitete që realizohen në sfondin e aktiviteteve të tjera

**A.23** – Diskutime mbi mësimdhënien, të nxënit dhe aktivitetet;
**A.24** – Mbajtja e shënimeve nga studenti;
**A.25 -** Pjesëmarrja në plotësimin e dokumentacionit shkollor dhe atij si student;
**A.26 –** Takime me tematika të ndryshme mbi ecurinë dhe vlerësimin e PP.

Këto 26 aktivitete, grupuar sipas kësaj strukture, shërbejnë për të trija fazat e PP. Gjithsesi, nga faza në fazë, ato bëhen më përfshirëse, më të integruara. Nëse psh. vëzhgimi në fillim të fazës së parë është aktivitet më vete dhe orientohet drejt tematikave të veçanta si veçoritë psikologjike të fëmijëve etj., në fazën e tretë kjo është e ndërthurur me atë se sa format, metodat, strategjitë përshtaten me veçoritë e fëmijës dhe sigurojnë përparimin e tij, pa harruar që tashmë studenti nuk është thjesht në rolin e vëzhguesit por në rolin e mësuesit (duke dhënë mësim). Në kapitujt pasues jepen detajimet e nevojshme për aktivitetet në secilën fazë.

## 2.3 Korniza e aftësive dhe e kompetencave

FSHE, në linjën e programeve të studimit dhe atyre lëndore që synojnë përgatitjen sa më të mirë dhe me kërkesat në avancim të vazhdueshëm të mësuesve të rinj, ka ndërtuar kornizën e aftësive dhe të kompetencave të pritshme për studentin- mësues, për secilën fazë. Korniza e kompetencave është "përkthimi" në formulime apo përshkrime të sintetizuara, të aftësive, zotësive apo kompetencave të shpresuara për t'u arritur nga studentët përgjatë realizimit të aktiviteteve të dizajnuara, për secilën fazë të praktikës profesionale. Ajo gjithashtu është rezultat i një procesi që ka kaluar përmes:

- hulumtimit me studentët e programeve të përgatitjes së mësuesve të rinj;
- konsultimit me programet e studimit në FSHE;
- konsultave me mentorë, tutorë dhe aktorë të tjerë;
- eksplorimit me përvojat e mëparshme të FSHE-së;
- Studimit të Standardeve Kombëtare të Mësuesve në APU.

Korniza është e ndarë në tri pjesë, një për secilën fazë pasi edhe gjerësia dhe thellësia e përfshirjes së studentit në rolin e mësuesit është e përshkallëzuar.

Është e kuptueshme se nuk mund të kemi një strukturë të plotë të një "profili profesional të mësuesit" te studenti, që nga faza e parë e praktikës profesionale deri në atë të fundit. Vetëm faza e tretë do t'i përqaset më shumë një pamjeje më të plotë të kompetencave të mësuesit.
Edhe pse nuk mund të pretendohet që një kornizë të mund të rrokë dhe përshkruajë në detaje gjithshka pasi natyra e punës me fëmijët është shumë njerëzore, dinamike, komplekse, me lidhje e varësi të shumëllojta, korniza e këtij udhëzuesi është një risi që i mundëson studentit, mentorit dhe tutorit të orientohen, udhëhiqen dhe garantojnë formimin profesional të studentit – mësues.
Për lehtësi trajtimi dhe përdorimi, të trija pjesët e kornizës së aftësive dhe të kompetencave do të trajtohen në vazhdim në kapitujt përkatës të fazës së parë, të dytë dhe të tretë të PP.

## 2.4 Vlerësimi

Vlerësimi i performancës së studentit në fund të çdo faze të PP kalon përmes një procesi ku aktorët kryesorë janë studenti, mentori dhe tutori. Nëse studenti ka përgjegjësinë e ndjekjes së programit të PP dhe mentori atë të udhëheqjes dhe të vlerësimit të formimit profesional në kushtet e shkollës/kopshtit, tutori ka përgjegjësinë përfundimtare dhe ligjore të vlerësimit me notë të studentit, në kuadrin e programit universitar të studimit. Në përfundim të çdo viti akademik studenti vlerësohet me notë për PP.

Studenti ka për detyrë dokumentimin e aktivitetit të tij në përmbushje të programit përmes "portofolit të studentit" për PP. Risia e këtij udhëzuesi është që korniza e aftësive dhe e kompetencave mundëson vlerësimin e profilit profesional të arritur nga studenti, në raport me pritshmëritë për secilën fazë.
Për vlerësimin e studentit ndiqet rruga që përfaqëson:

- kombinimin e plotësimit të parakushteve të pjesëmarrjes dhe dokumentimit nga studenti të PP (si rregull janë eliminatore);
- vlerësimit të profilit profesional sipas modelit A-K-V: Aktivitete **(A)** – Kompetenca **(K)** – Vlerësim **(V).**

Portofoli i Praktikës Profesionale

Studenti në tre vitet e studimit akademik në programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" krijon një Portofol i cili do të përdoret për të vlerësuar në progres veprimtarinë e tij përgjatë Praktikës Profesionale sipas tri fazave (PP seriale/pasive dhe PP/Bllok, aktive) në formimin fillestar të studentëve - mësues**.** Kompetencat e mësuesit të arsimit parashkollor nuk

krijohen shpejt por ato burojnë nga aftësitë e formuara gradualisht gjatë praktikës dhe procesit të reflektimit duke respektuar parimin nga më e thjeshta te më e komplikuara. Ndaj njohuritë, aftësitë, shprehitë e qëndrimet ky student duhet t'i fitojë e demonstrojë përgjatë studimeve dhe specikikisht, lënda e PP e luan këtë rol më së miri duke ndihmuar në formimin e tyre fillestar si mësues në disa drejtime kryesore: në atë të kompetencave lëndore, në kurrikulën përmbajtjesore të arsimit parashkollor, si dhe në aftësitë praktike. Portofoli i PP do të përbëhet nga dokumentacioni përgjegjës për tri fazat e praktikës profesionale, i përbërë nga formularë vëzhgimi, detyra studimore si dhe formularë vlerësimi e vetëvlerësimi. Studenti praktikant gjatë PP si vëzhdues, ndihmës apo mësimdhënës: vlerësohet, vlerëson, vetëvlerësohet dhe reflekton. Studenti bashkëpunon me mentorin duke diskutuar dhe kërkuar informacion shtesë si dhe komunikon me mbikqyrësin universitar për to përgjatë gjithë procesit të PP. Formularët apo detyrat studimore vendosen në dosjen e studentit, e cila është objekt monitorimi.

Për vlerësimin e profilit profesional, mbështetur në kornizën e aftësive dhe të kompetencave, përdoret modeli i pikëzimit që përdor MASR[9]. Në përputhje me këtë, katër nivelet vlerësuese për çdo aktivitet janë si më poshtë:

| **Niveli** | **Emërtimi** | **Pikët** | **Klasifikimi** |
|---|---|---|---|
| **I parë** | Shumë mirë | 4 | Pozitiv |
| **I dytë** | Mirë | 3 | Pozitiv |
| **I tretë** | Mjaftueshëm | 2 | Pozitiv |
| **I katërt** | Jo mjaftueshëm | 1 | Negativ |

Pikët nga vlerësimet për secilin formulim nga korniza e aftësive dhe e kompetencave, për secilin grup aktivitetesh, mblidhen dhe shumës i gjendet mesatarja aritmetike. Kjo mesatare konvertohet në notë, sipas tabelës së mëposhtme:

| **Niveli** | **Emërtimi** | **Pikët** | **Nënnivele** | **Nota** |
|---|---|---|---|---|
| **I parë** | Shumë mirë | 3.4 - 4.0 | 3.7 - 4.0 | 10 |
| | | | 3.4 – 3.6 | 9 |
| **I dytë** | Mirë | 2.6 - 3.3 | 3.0 - 3.3 | 8 |
| | | | 2.6 - 2.9 | 7 |
| **I tretë** | Mjaftueshëm | 1.9 – 2.5 | 2.2 – 2.5 | 6 |
| | | | 1.9 – 2.2 | 5 |
| **I katërt** | Jo mjaftueshëm | 1.0 – 1.8 | 1.5 – 1.8 | 4 |
| | | | 1.0 – 1.4 | 4 |

9 MASR&ASCAP: "Standardet Profesionale të Formimit të Përgjithshëm dhe të Formimit Lëndor të Mësuesit në Sistemin Arsimor Parauniversitar", Tiranë 2020.

## 2.5 Kujtesë për koordinatorin, tutorin, mentorin dhe studentin

Përveç detyrave dhe përgjegjësive të përgjithshme të listuara në pjesët e mëparshme të këtij udhëzuesi, aktorët kryesorë të PP duhet të kenë në vëmendje disa aspekte dhe konsiderata të rëndësishme. Rekomandojmë rileximin e tyre në fillim të çdo faze të PP.

***Kujtesë për koordinatorin universitar:***

- Para fillimit të PP duhet të keni komunikuar me bashkinë dhe ZVAP dhe të keni lidhur marrëveshje për shkollat/kopshtet që do të jenë në rolin e IAPP, numrin e studentëve etj;
- Hartoni planin e shpërndarjes së studentëve në IAPP në bashkëpunim me tutorët dhe jini të gatshëm për të komunikuar me studentët për rregullat e PP;
- Përgatitni dhe nënshkruani marrëveshjen e bashkëpunimit me bashkinë dhe ZVAP;
- Bashkëpunoni me tutorët për të garantuar parapërgatitjen optimale të studentëve nga ana emocionale për PP si një nga komponentët më të rëndësishëm të programit të studimit;
- Bashkëpunoni me tutorët dhe IAPP sa herë që nevojitet lidhur me organizimin dhe koordinimin midis IAL, DRAP, ZVAP dhe IAPP.

***Kujtesë për tutorin:***

- Njih mirë studentët për të cilët jeni përgjegjës si tutor;
- Kontakto paraprakisht me mentorin dhe diskuto për aspekte të mbarëvajtjes së PP;
- Bashkë me koordinatorin organizoni aktivitetin e parë prezantues dhe njohës me studentët tuaj, në FSHE, ku do të jepni të gjitha udhëzimet për anën organizative dhe përmbajtësore;
- Sigurohuni që studenti të pajiset dhe të njohë udhëzuesin e PP në detaje, detyrat dhe përgjegjësitë që ka, veçanërisht të kuptojë linjën e formimit profesional që do të kalojë, aftësitë dhe kompetencat që duhet të formësojë;
- Kujtoji studentit që PP është shumë e lidhur me programet e tjera lëndore që zhvillon paralelisht në FSHE;
- Mbaj kontakte të rregullta me studentët dhe mentorin, gjatë gjithë periudhës së PP, për të garantuar angazhimin dhe suksesin maksimal të studentit.

***Kujtesë për mentorin:***

- Jeni eksperti që udhëhiqni studentin në rrugën e formimit profesional në terrenin praktik, si i tillë por edhe si bashkëpunëtor gëzoni respektin

maksimal të FSHE-së;
- Trajtojeni studentin si nxënës dhe koleg, krijoni atmosferë miqësore dhe motivuese;
- Njihni udhëzuesin e PP në detaje, fazat dhe hapat e parashikuar të përfshirjes së studentit për një kalim të natyrshëm nga më e lehta te më vështira, nga më e thjeshta te më e ndërlikuara;
- Familjarizohuni me kornizën e aftësive dhe të kompetencave. Niveli maksimal në këtë kornizë përcakton edhe standardin e përgatitjes së mësuesve të rinj në FSHE. Ju jeni kontribues në këtë standard të vendosur;
- Insistoni veçanërisht në kompetencat e evidentuara të mësuesit të shekullit të 21-të, kërkimi në edukim, reflektimi dhe përdorimi i TI;
- Studentët kanë individualitetet e tyre të papërsëritëshme dhe në përputhje me këto reflektojnë dallime në rrugëtimin e formimit profesional. Brenda kornizave të përcaktuara nga ky udhëzues përmes aktiviteteve, koha dhe shkalla e një përfshirjeje të studentit apo kalimi nga një aktivitet në një tjetër më të avancuar është e drejtë dhe përgjegjësi e juaja;
- Komunikoni shpesh me tutorin, informojeni në mënyrë formale dhe informale mbi ecurinë e studentëve.

***Kujtesë për studentin:***

- PP është ndoshta pjesa më e rëndësishme e programit të studimit në universitet që do ju formësojë profesionalisht, si mësues i ardhshëm;
- Duhet të njihni të gjithë aspektet e zhvillimit të PP përmes leximit të rregulloreve të IAL, IAPP, udhëzuesit të PP, komunikimit me Ko, T, M etj. Mos hezitoni të pyesni personat që kujdesen për ju, për çdo rast;
- Pranimi juaj në shkolla/kopshte për zhvillimin e PP është besim dhe mundësi e madhe që ju jepet. Ju do të ndikoni në jetën e shkollës/kopshtit dhe të fëmijëve prandaj dhe duhet të zbatoni disiplinën formale dhe profesionale, rregulloren e shkollës/kopshtit dhe kodin e etikës njëlloj si mësuesit e tjerë;
- Nuk mund të jeni i suksesshëm nëse nuk njihni kërkesat për formimin profesional të shpresuar. Duhet të njihni shumë mirë jo vetëm rregullat bazë të angazhimit që mund të jenë edhe eliminuese por edhe kornizën e aftësive dhe të kompetencave që duhet të formësoni përmes praktikës bashkë me mënyrën e vlerësimit përfundimtar të profilit tuaj professional;
- FSHE ka besim te ju dhe pret që ta përfaqësoni denjësisht.

# Pjesa III

# FAZA E PARË E PRAKTIKËS PROFESIONALE

## 3.1 Informacion mbi vendin e PP në programin e studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor për fazën 1

Praktika Profesionale në programin e studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor është e shtrirë përgjatë tre viteve dhe është e organizuar në "Praktikë seriale" dhe "Praktikë bllok".
Struktura e shtrirjes së praktikës profesionale është si në tabelë:

| **Struktura Mësimore**: **Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Sem. I | Sem. II | Sem. III | Sem. IV | Sem. V | Sem. VI |
| **Mësim** | 15 javë | 15 javë | 15 javë | 13 javë | 15 javë | 7 javë |
| **Praktikë profesionale** | 1 ditë/ 2javë | 1 ditë/ 2javë | 1 ditë/ 2javë | 1 ditë/ javë + 2 javë | 1 ditë/ javë | 1 ditë/ javë + 8 javë |

Në vitin e parë, praktika profesionale zhvillohet me 1 ditë / 2 javë për semestrin I dhe II dhe është praktikë seriale. Termi seriale nënkupton zhvillimin periodik të PP me ditë të plotë qëndrimi në institucionet parashkollore, krahas procesit mësimor në auditore. Gjatë semestrit të parë, në programin e studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, zhvillohen lëndët: Hyrje në psikologji, Edukim qytetar demokratik, Gjuhë shqipe I, Matematikë, Bota sociale e fëmijës, Gjuhë e huaj –Anglisht etj.
Gjatë semestrit të dytë, në programin e studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, zhvillohen lëndët: Psikologji zhvillimi, Arsimi gjithëpërfshirës, Gjuhë shqipe II, Histori e Shqipërisë, Kujdesi për veten, siguria, higjiena etj.
Studentët atashohen pranë institucioneve parashkollore të përzgjedhura dhe të përcaktuara nga marrëveshjet e nënshkruara mes intitucionit UE dhe Bashkisë Elbasan. Vendosja në kopshte në kuadër të PP njëkohësisht shërben si mundësi në favor të një lidhjeje të ngushtë midis teorisë dhe praktikës apo si një laborator ku konfirmohen njohuritë dhe fitohen aftësi e kompetenca.

**Portofoli i studentit në fazën e parë të praktikës përmban:**

1. **Formular vëzhgimi në grup/klasë** i cili orienton vëzhgimin që studenti duhet të bëjë për veprimtarinë mësimore edukative në kopsht.
2. **Formular vëzhgimi mbi mjedisin fizik në kopsht**, i cili orienton vëzhgimin që studenti duhet të bëjë për mjedisin fizik të jashtëm dhe të brendshëm si dhe qendrat e veprimtarive.
3. **Detyrë studimore me temë**: "Një fëmije në studim" bazuar në "Standardet e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç".
4. **Formular vëzhgimi mbi parimin e gjithëpërfshirjes** i cili orienton studentin që të vëzhgojë se si krijohet një mjedis gjithëpërfshirës në të cilin fëmijëve u jepet mundësia të zhvillojnë potencialin e tyre, pavarësisht gjinisë, nivelit social-ekonomik, besimit fetar, racës, grupit etnik ose aftësive të tyre fizike dhe mendore.
5. **Formular vëzhgimi mbi partneritetin familje- komunitet** i cili orienton studentin që të vëzhgojë se si planifikimi, hartimi, zbatimi i kurrikulës dhe, mbi të gjitha, arritja e rezultateve të të nxënit, kërkojnë bashkëpunim me familjen, komunitetin.
6. **Raport vlerësimi** i plotësuar nga mentori bazuar në bashkëpunimin student-mentor; frekuentimin dhe korrektësinë në respektimin e orarit të ardhjes dhe të largimit nga kopshti, disiplinës vëzhguese, veshjes dhe sjelljes së përshtatshme; angazhim gjatë dhe pas vëzhgimit.

# AKTIVITETET E FAZËS SË PARË

## 1.1.1 Aktivitetet e grupit të parë ($A_{1,2,3,4,5}$)

### Parapërgatitja dhe njohja

| A | Formulimi i aktiviteteve | Detajimi dhe përshkrimi i aktiviteteve | Ku/kush | Kur |
|---|---|---|---|---|
| **A1** | Njohja me sistemin e PP | Takim:<br>• Studentët pajisen me udhëzuesin e PP.<br>• Prezantohet struktura e PP.<br>• Diskutohet në parim se ç'është sistemi i mentorëve, detyrat dhe përgjegjësitë e studentit, mbikqyrësit, mentorit dhe përfitimet individuale e institucionale.<br>• Komunikohet plani i shpërndarjes në shkolla/kopshte dhe çështje të tjera organizative. | F<br>Ko<br>T<br>St | Para PP ose Dita 1 e PP |
| **A2** | Vizita e parë në shkollë/ kopsht | Dita e parë në shkollë:<br>• Prezantim me drejtuesit, mësues etj. shprehet mirëseardhja, flitet mbi shkollën/kopshtin, historinë, të tashmen.<br>• Njohje me mjediset kryesore të shkollës/kopshtit.<br>• Prezantim me grupin e fëmijëve ku do të angazhohen.<br>• Prezantim me linjat e përgjithshme të mentorimit, përfshirjen dhe detyrat në rritje të studentit në F1.<br>• Jepen porosi mbi portofolin e studentit për F1. | IAP<br>M,T | Dita 1 ose Dita 2 e PP |
| **A3** | Njohuri ligjore mbi Institucionin Arsimor | Njohje e organizuar me:<br>• Ligji për Arsimin Parauniversitar (Nr. 69.2012).<br>• Rregullore për funksionimin e IAP në RSH (01.2020).<br>• Rregullore e PP.<br>• Rregullore e shkollës/kopshtit.<br>• Akte të ndryshme nënligjore - gradualisht | IAP, F<br>MT | Java 1 dhe 2 e PP e në vazhdim |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **A4** | Njohja me dokumentacionin e shkollës/ kopshtit dhe atë të detyrueshëm të studentit praktikant; | Njohje e organizuar dhe në vazhdimësi me: Dokumentacioni standard dhe ai zhvillimor i shkollës/kopshtit. Dokumentacioni standard i mësuesit (dosja e mësuesit). | IAP<br>M | N ë vazhdim |
| **A5** | Njohja me literaturën, veçanërisht me botime të MAS dhe IZHA | Njohja, kontakti me literaturën:<br>• Botime të MASR<br>• Botime të ASCAP<br>• Botime të IZHA<br>• Botime dhe literaturë shqiptare<br>• Botime profesionale dhe literaturë e huaj | IAP, F<br>M,T,PL | |

## 3.2.2 Aktivitetet e grupit të dytë ($A_{6,7,8,9}$):

### Vëzhgimi dhe mbajtja e shënimeve

| A | Formulimi i aktiviteteve | Detajimi dhe përshkrimi i aktiviteteve | Ku/kush | Kur |
|---|---|---|---|---|
| **A6** | Prani/vëzhgime/shënime gjatë përgatitjes së një ore/dite mësimi; | Parapërgatitja e orës/ditës së mësimit:<br>• Diskutim mbi format, mënyrat, kontekstet e vëzhgimit.<br>• Diskutim mbi format, teknikat e mbajtjes së shënimeve<br>• Vëzhgim dhe mbajtje shënimesh mbi parapërgatitjen e një ore dhe një dite mësimi. | IAP<br>M<br>St | Java 2 e në vazhdim |
| **A7** | Prani/ vëzhgime/ shënime gjatë zhvillimit të mësimit; | Gjatë zhvillimit të orës së mësimit:<br>• Diskutim mbi veçoritë e vëzhgimit/ shënimeve gjatë zhvillimit të një ore mësimi.<br>• Prani dhe realizim vëzhgimi me objektiva të caktuara gjatë zhvillimit të orëve mësimore.<br>• Prani dhe mbajtje shënimesh duke përdorur larmi formash, mënyrash dhe mjetesh gjatë zhvillimit të orëve mësimore. | IAP<br>M<br>St | Java 2 e në vazhdim |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
